



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. _____ /2022
Dt. 28.12.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. Paragrafi 2 Pika (d), nenit 40 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në mbledhjen e mbajtur me datë. 28.12.2022, pas diskutimeve lidhur më pikën e 9-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës që Lulëkuqja me katër Petalet të bëhet Simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë, e miratoi këtë:

DEKLARATË

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës Përkrah dhe mbështet idenë, respektivisht kërkesën e qendrës “ Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur“, që Lulëkuqja me katër Petalet të jetë Simbol i viktimave të Gjenocidit në Kosovë dhe kësisoj Lulëkuqja me katër petalet të bëhet simbol Unik i përkujtimit të Gjenocidit në Kosovë.
2. Kuvendi i Komunës së Gjakovës konsideron se katër petalet e lulëkuqes në logon e dizajnuar paraqesin qartë katër format e akteve Gjenocidale që Serbia zbatoj në Kosovë : vrasjen, dhunën seksuale, spastrimin etnik dhe shkatërrimin e objekteve që lidhën me përkatësin Etnike dhe Identitetin Shqiptar.
3. Kjo deklaratë hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesja e Kuvendit.
4. **Vendimi iu dërgohet:**
 - z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës .
 - Arkivit,

Arbëneshë Kuqi
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës